

VENDIM
Nr. 660, datë 2.9.2026

PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË NJË PJESE TË PASURISË NR. 8/738, ZONA KADASTRALE 8340, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT “KOMPLEKSI GOVERNATIV, BULEVARDI I RI, TIRANË”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 434, DATË 6.3.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN E PASURIVE, TROJE DHE OBJEKTE, ME INTERES VENDOR, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 120, DATË 4.3.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, si dhe në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pjesës prej 2 431 (dy mijë e katërqind e tridhjetë e një) m², të pasurisë nr. 8/738, zona kadastrale 8340, me sipërfaqe të përgjithshme 20 528.3 (njëzet mijë e pesëqind e njëzet e tetë pikë tre) m², sipas shtojcës nr. 1 dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për realizimin/financimin e projektit të investimit “Kompleksi Governativ, Bulevardi i Ri, Tiranë”, përfshirë përmbushjen e nevojave për ambiente funksionale për institucionet publike përfituese dhe Hekurudhën Shqiptare sh.a., si dhe zhvillimin e stacionit të ri hekurudhor. Shpenzimet e projektimit, ndërtimit dhe vënies në funksion mbulohen nga nënprojektet e projektit të investimit “Copëzat” dhe nga projekte të tjera të Korporatës së Investimeve Shqiptare.

2. Autorizimin e shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, vetë ose nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues, nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes, për realizimin e projektit të investimit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, dhe përmbushjen e interesit publik, që lidhet me nevojat e institucioneve, të përcaktuara në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Autorizimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe institucioneve, të përcaktuara në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, vetë apo nëpërmjet institucioneve të autorizuar prej tyre, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetit në pronësi apo përgjegjësi administrimi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore, që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës apo përmbushjes së interesit të Korporatës, kushteve e nevojave për dorëzimin e pronës së re.

4. Autorizimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare për negocimin me subjekte private dhe publike, me qëllim lidhjen e kontratave përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara, në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit, bazuar në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë,

leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij.

5. Autorizimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare, vetë ose nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me:

a) Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për ndarjen e pjesës së pasurisë, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në kuadër të realizimit të projektit të investimit;

b) institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit;

c) sigurimin e regjistrimit në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit të pronave të reja shtetërore, që do të krijohen në kuadër të projektit të investimit.

6. Në funksion të zhvillimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, kur është e nevojshme, për realizimin e projektit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar:

a) me prishjen e objekteve, pjesë e pronës së përcaktuar në këtë vendim;

b) në zbatim të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, të kryejë procesin e konsolidimit të pronës, në rast se konstatohet mospërputhje ndërmjet gjendjes faktike dhe gjendjes juridike të saj.

7. Në vendimin nr. 434, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e pasurive, troje dhe objekte, me interes vendor, në pronësi të Bashkisë së Tiranës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 120, datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit’, të ndryshuar”, hiqet pjesa prej 2 431 (dy mijë e katërqind e tridhjetë e një) m² e pasurisë nr. 8/738, zona kadastrale 8340, sipas shtojcës nr. 1 dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, institucionet përfituese të përcaktuara në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, Bashkia Tiranë, Hekurudha Shqiptare sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

PRONA QË TRANSFEROHET NË PRONËSI TË KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE

Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë truall (m ²)	Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
8340	8/738	20 528.3 (nga e cila kalon në pronësi vetëm pjesa prej 2 431 m ² , sipas planit të rilevimit bashkëlidhur)	Bashkia Tiranë, VKM-ja nr. 434, datë 6.3.2013, e ndryshuar

SHTOJCA NR. 2

INSTITUCIONET PUBLIKE, TË CILAT LIDHIN MARRËVESHJEN E

BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, entitetet dhe institucionet e përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe çdo entitet publik përfutues, sipas kërkesës së tyre dhe brenda mundësive funksionale të objektit publik “Kompleksi Governativ, Bulevardi i Ri, Tiranë” dhe Hekurudha Shqiptare sh.a.

PLANI I RILEVIMIT I PASURISË NR. 8/738, ZONA KADASTRALE 8340

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: BASHKIA TIRANE

DATË:

QËLLIMI: NEGOCIM ME BASHKINE TIRANE

VENDNDODHJA: TIRANE BASHKIA TIRANE DVASHK/ZVASHK TIRANA ZONA KADASTRALE 8340 NR.PASURISË 8/738 INDEKS HARTE TR-I,J,K,L-10-11
TË DHËNAT E PASURISË: LLOJII PASURISË TRUALL SIP. E PASURISË = 20528.3m² SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT = - m² Nr.KATEVE ____ Nr.PEMËVE ____

X 400456.25
Y 4577820.68

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 401141.76
Y 4577820.68



X 400456.25
Y 4577820.68

SHKALLA 1:2500

X 401141.76
Y 4577820.68

Nr	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT

Emri: **GEZIM SALJA**
Liçensa Nr. **T.0066/4** Date. 14.05.2018
Kompania: **"GS ALBANIA"**
Data e Përgatitjes: 13.07.2026
Nënshkrimi/vula

REALIZOI PËR ASHK

SPECIALISTI _____

DVASHK _____

NËNSHKRIMI _____

KONFIRMO!

PËRGJEGJËS/DREJTORI _____

NËNSHKRIMI/VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE

Kode për teknologjinë e matjeve: Z
T - Terren; Z - Zyrë; O - Ortofoto; G - Gps; S - Stacion Total; D - Matje Distancash;

PËRCAKTIMI I KUFIRIT

Kode për përcaktimin e kufirit: _____
P - Përfaqësues i Pronarëve; K - Kufitarët të gjithë; KP - Kufitarët Pjesërisht;
PB - Përfaqësues Bashkie; HK - Harta Kadastrale;

SHËNIME TË VEÇANTA:

PRONARI/BASHKËPRONARËT - DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT

EMRI _____

NËNSHKRIMI _____

Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimin e kufirit:

T - Terren; Z - Zyrë; O - Ortofoto; G - Gps; S - Stacion Total; D - Matje Distancash; P - Përfaqësues i Pronarëve; K - Kufitarët të gjithë; KP - Kufitarët Pjesërisht;
PB - Përfaqësues Bashkie; HK - Harta Kadastrale;